

7 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.22/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB GO+Peja për regjistrimin e lojtarit Fatlind Shoshaj, si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave **MIRATON** kërkesën e KB GO+Peja për lejimin e regjistrimit të lojtarit Fatlind Shoshaj.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ Lojtar i lirë (free agent) – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM


Gjatë vendimarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.22/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave i FBK-së shqyrtoi kërkesën e KB GO+Peja për regjistrimin e lojtarit **Fatlind Shoshaj** si lojtar i lirë, jashtë afatit kalimtar.
- (b) Pas verifikimeve, bazuar në **Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së 2025/2026**, konstatohet se në këtë rast zbatohet **Neni 13.6, pika 4**, pasi vlerësohet se është në interes të basketbollit kosovar dhe të përfaqësimit kombëtar.
- (c) Nga dosja e lëndës rezulton se lojtari nuk ka kontratë aktive me asnjë klub tjetër, fakt i vërtetuar edhe me **“Letter of Clearance”** të datës **07.01.2026** nga ish-klubi **Gembo Borgerhout**.
- (d) Komisioni i Garave vlerësoi se angazhimi i lojtarit **Fatlind Shoshaj** në ligën e Kosovës ndikon pozitivisht në rritjen e nivelit të basketbollit kosovar. Për më tepër, lojtari ka përfaqësuar Kosovën në kategorinë **U20** dhe ka qenë i grumbulluar edhe me **Përfaqësuesen A të Kosovës**. Aktivizimi i lojtarit Fatlind Shoshaj në ProCredit Superligën e Kosovës është në interes të veçantë të përfaqësimit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, duke krijuar mundësinë e angazhimit të tij të mëtejshëm në Përfaqësuesen e Kosovës.
- (e) Duke u mbështetur në dispozitat përkatëse të **Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026**, Komisioni i Garave vlerëson se kërkesa e **KB GO+Peja** është e bazuar dhe në përputhje me aktet normative në fuqi, dhe si e tillë **miratohet**, duke lejuar regjistrimin e lojtarit **Fatlind Shoshaj** për klubin **KB GO+Peja** me të drejtë loje të menjëhershme.
- (f) **Udhëzohet personi përgjegjës në FBK** që të procedojë me regjistrimin e lojtarit **Fatlind Shoshaj** për klubin **KB GO+Peja** me të drejtë loje të menjëhershme, në përputhje me rregulloret në fuqi të FBK-së.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.